

**PAKR.nr.579/17**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Driton Muharremi kryetar, Have Haliti dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.K. nga fsh. ..., Komuna e Ferizajit, për shkak të veprës penale mbajtja në kontrolle, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së, dhe veprës penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, dhe ankesës së të akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.147/16 të datës 31.07.2017, në seancën e kolegjit, me datë 18.01.2018, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Refuzohen, si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ankesa e të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.147/16 të datës 31.07.2017, vërtetohet.

## **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-DKR në Ferizaj, PKR.nr.147/16 të datës 31.07.2017, i akuzuari K.G., është shpallur fajtor për veprat penale; mbajtja në kontrolle, posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, për veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, dhe për veprën penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve. Konform nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarit i është shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vjet e 6 (gjashtë)muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga dt. 18.05.2016 deri më dt. 16.06.2016, kurse pjesa e mbetur do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit K.Sh. dhe N.B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari është i obliguar që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës dhe në emër të paushallit gjyqësorë të paguajë shumën prej 50 €, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore-DKR-në Ferizaj, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë.

I akuzuari K.G., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin duke u thirrur në dispozitat e nenit 383, 386 dhe 387 të KPPK-së, me propozim që të lirohet nga akuza .

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/I.nr.543/17 me datë 26.12.2017, ka propozuar që të aprovet ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i lartë me burgim, ndërsa të refuzohet si e pabazuar ankesa e të akuzuarit K.G..

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 dhe 4 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit në të cilën prezantuan, i akuzuari K.G., ndërsa, nuk kanë prezantuar Prokurori i Apelit dhe të dëmtuarit N.B. dhe K.Sh., për të cilët ka prova se janë ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit, ka shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë dhe të akuzuarit, pas vlerësimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe ankesa e të akuzuarit, janë të pabazuara.

I akuzuari pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke u thirrur në shkeljet nga neni 383 të KPPK-së, për të gjitha bazat pa e bërë dallimin në mes të tyre duke cekur se për pikën I-rë dhe të II-të, nuk e ndien veten fajtor, kurse për pikën e III-të të akuzës e ndien veten fajtor dhe për të njëjtën kërkon falje. I akuzuari pretendon se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e ka bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, pa pasur prova materiale, sepse arma me të cilën pretendohet se është shtënë nuk është gjetur dhe nuk ka pasur ndonjë motiv që të shtënë me armë.

Gjykata e Apelit, duke i vlerësuar pretendimet e të akuzuarit, por edhe sipas detyrës zyrtare, vlerëson se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit, se nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kjo gjykatë i vëren edhe sipas detyrës zyrtare, i akuzuari në ankesë nuk ka cekur se cilat kanë qenë ato shkelje nga ana e gjykatës se shkallës së parë. Në aktgjykimin me të cilin i akuzuari është shpallur fajtor janë përshkruar faktet dhe rrethanat që përbejnë figurën e veprave penale dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të KP, ashtu si është paraparë në nenin 365 par.1 nën.par.1 të KPPK. Dispozitivi i aktgjykimit nuk ka kundërthënë ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së shkresave, arsyetimi ka mbështetje në provat e administruara.

I akuzuari, në ankesë pretendon, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, se gjykata e shkallës së parë, me asnjë provë nuk ka vërtetuar, se i ka kryer veprat penale nën pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit, se nuk është vërtetuar se a e ka poseduar dhe përdorur armën ndaj të dëmtuarës K.Sh., arma sipas aktgjykimit ka qenë e paidentifikuar, se nuk ka pasur motiv që natën kritike të ndërmarrë një veprim të tillë, sepse me K.Sh. ka këmbyer mesazhe në vazhdimësi, ka pasur edhe marrëdhënie intime dhe se natën kritike pasi që e ka kuptuar se nuk e kishte bashkëshortin në shtëpi ka shkuar ta vizitojë, por K. i kishte thënë se fëmijët i ka zgjuar dhe kishte një fqinjë, e ka lutur duke i thënë shko sonte se do të shihemi ndonjë ditë tjetër në Gjilan, menjëherë është

larguar nga shtëpia e saj, pa e përdorur armën dhe e gjithë kjo i është mvëshur nga bashkëshorti i të dëmtuarës K., pasi që ia ka kontrolluar telefonin e K. dhe i ka parë SMS-at, për të mbuluar marrjen që mos të bëhet edhe më e madhe dhe mos ta marrin vesh familjarët e K., N. e ka paraqitur në polici, se gjëja ky ka shtënë armë, prokurori ka qenë i obliguar që t'i mbledhë provat si ato fajësuese dhe ato shfajësuese ku në rastin konkret prokurori nuk ka gjetur prova fajësuese dhe është dashur që të vendos në favorin e tij.

Gjykata e Apelit, i ka vlerësuar pretendimet e të akuzuarit dhe ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, sepse nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dëshmitë e të dëmtuarës K.Sh., të dëmtuarit N.B., dëshmitarit A.A. dhe provave materiale, raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes nga njësia e fornezikës së Stacionit Policor në Ferizaj, të dt. 01.05.2016, mesazheve të dërguara nga telefoni i të akuzuarit me nr.044-524-674, në telefonin e të dëmtuarës K.Sh. me nr.044 841-753, të datës 01.05.2016, dhe fotografive nga vendi i ngjarjes, drejtë ka vërtetuar se i akuzuari K.G., me datën 01.05.2016, në fsh. ..., Komuna e Ferizajt, ka mbajtur në posedim pautorizim armë në kundërshtim me ligjin, ku në të njëjtën datë rreth orës 01,00 min. në fsh. ..., K. e Ferizajit, në oborrin e shtëpisë së N.B., e ka përdorur revolen e tipit të paidentifikuar, në atë mënyrë që pas shkëmbimit të disa mesazheve me të dëmtuarën K.Sh.-bashkëshorten e N.B., nga e cila kishte kërkuar që të hapte derën e shtëpisë për të hyrë brenda, e kur e dëmtuara nuk e ka hapur derën i akuzuari në shenjë revolte ka hyrë në oborrin e shtëpisë dhe ka shtënë njëherë në drejtim të dritares së dhomës së ndejës-sallonit nga një largësi prej 3-5 m. e që plumbi përveç thyerjes së xhamit ka goditur edhe murin mbi derën e dhomës dhe ka përfunduar në korridor, me këtë ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK-së.

I akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Ferizaj, më dt. 31.07.2017, rreth orës 10,30 min. me qëllim të frikësimit e ka kanosur të dëmtuarin N.B., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ka qenë duke u marrë në pyetje në cilësinë e dëshmitarit në sallën e gjykimit nr. 2 të kësaj gjykate, i akuzuari iu ka drejtuar me fjalët “unë do t'i tregojë atij kur të dal nga burgu me Kanunin e Lekë Dukagjinit” i cili kërcënim ka shkaktuar frikë tek i dëmtuari.

Se nuk është kontestuese se i akuzuari natën kritike, ka shkuar të shtëpia e të dëmtuarit N.B., e kur e ka vërtetuar nga bashkëshortja e tij K.Sh., se N. është në punë në ndërrimin e natës, prapë rreth orës 24,00 ka shkuar në shtëpi ka trokitur në derë ka kërkuar që K. t'ia hap derën, por ajo i kishte thënë largohu se i ka fëmijët zgjuar, i ka shkruar SMS, e pastaj në shenjë revolte ka hyrë në oborrin e shtëpisë dhe ka shtënë njëherë në drejtim të dritares së dhomës së ndejës-sallonit nga një largësi prej 3-5 m. e që plumbi përveç thyerjes së xhamit e ka goditur edhe murin mbi derën e dhomës dhe ka përfunduar në korridor.

Se nuk është kontestuese se e dëmtuara K.Sh., e ka parë të akuzuarin nga dritarja në oborr se ka pasur ndriçim dhe pas 2-3 min. pas SMS të fundit, i akuzuari ka shtënë me revole, pastaj është larguar menjëherë nga vendi i ngjarjes, ku e dëmtuara e kishte njoftuar fqinun e saj A.A. dhe bashkëshortin e saj dhe polici, ku të gjithë i kishin parë xhamin e dritares të thyer dhe gëzhojën e plumbit në korridor.

Se nuk është kontestuese se i dëmtuari N.B. natën kritike kur i akuzuari ka shtënë me revole në shtëpinë e tij ka qenë në punë në fsh. ..., bashkëshortja e tij e ka thirrë me telefon dhe i ka thënë se dikush ka shtënë nga revolja dhe kur është kthyer në shtëpi e ka parë xhamin e sallonit të thyer dhe plumbi kishte mbetur në korridor dhe natën kritike nuk ka kuptuar se kush ka shtënë, por pas dy ditëve bashkëshortja ia ka treguar SMS-at të cilat ia kishte dërguar K.G., pas dy ditësh K. e ka thirrë me telefon dhe e ka pyetur se ku je, të njëjtit i ka thënë se është në Obiliq, ai ka shkuar në shtëpi e ka goditur derën e shtëpisë ka hyrë brenda dhe aty janë kacafytur në prezencën e fëmijëve, ku ka ndërhyrë vëllai i tij dhe i ka ndarë dhe K. është larguar nga shtëpia e tij dhe vetura i ka mbetur aty e pastaj e ka lajmëruar rastin në polici. Sipas të dëmtuarit më parë me K. i ka pasur raporte të mira, deri sa K. kishte kërkuar që ta dërgojë në fsh. Zhegër,

gjëja për tu takuar me një femër, ndërsa, ai kishte kryer vjedhjen, për këtë e ka paraqitur rastin në polici, sipas të dëmtuarit të gjitha këto K. i ka bërë për shkak të hakmarrjes ndaj tij.

E kjo është vërtetuar nga dëshmia e dëshmitarit A.A., i cili natën kritike pas gjuajtjes me armë nga ana e të akuzuarit ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarës pas thirrjes telefonike se dikush ka shtënë me armë në shtëpinë e saj.

Nga këto dëshmi të elaboruara më lartë, si dhe nga fotoalbumi nga Njësia e Teknikës Kriminalistike, vërtetohet se natën kritike është shtënë nga arma në dritaren e shtëpisë se të dëmtuarit N.B., ku shifet dritarja e thyer nga plumbi, pamja e vrimës nga predha në sallon nga ana e brendshme e derës, si dhe predha e plumbit në dyshtemenë e korridorit, kurse nga SMS-at që gjinden si prova në shkresat e lëndës, vërtetohet se i akuzuari ka këmbyer SMS me të dëmtuarën K.Sh., vetëm disa 2-3 min. para se me shtënë nga arma, çka nuk e mohon as vetë i akuzuari, se natën kritike ka qenë të shtëpia e të dëmtuarës pasi që ka kuptuar se bashkëshortin se ka pasur në shtëpi, ka tentuar të hyjë brenda, por K. i ka thënë se fëmijët i ka të zgjuar, kurse mbrohet se është larguar menjëherë nga oborri i shtëpisë, gjë që nuk e argumenton me asnjë provë, se e dëmtuara K. e ka parë të akuzuarin nga dritarja se ka pasur ndriçim, i dëmtuari ka trokitur në derë dhe dritare dhe terë kohën nuk është larguar derisa ka shtënë nga arma, kurse armen ka arritur të fshehtë.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e të akuzuarit, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë, se gjykata e shkallës së parë, drejte ka vërtetuar gjendje faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Prokuroria pretendon, se gjykata e shkallës së parë, dënimin që i ka shqiptuar të akuzuarit është i ulët, se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar dhe gjendet në vuajtjen e dënimit për vepra tjera penale, se në shqyrtimin gjyqësor e ka kanosur të dëmtuarin N.B., se nuk është penduar fare për veprat e kryera, ka propozuar që t'i shqiptohet një dënim më i lartë, se me dënimin e shqiptuar nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari ka propozuar që të lirohet nga akuza, për veprën penale nën pikën I dhe II, sepse nuk ka asnjë provë që e vërteton fajësinë e tij, kurse në ankesë e pranon veprën penale të kanosjes dhe i vjen keq.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të prokurorisë dhe të akuzuarit, se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë rrethanat që ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë se dënimit, nuk janë të bazuara, përkundrazi gjykata e shkallës së parë, drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar ato. Në ankesë nuk cekët ndonjë rrethanë konkrete e cila kishte me ndikuar që dënimin i të akuzuarit të jetë më i lartë, siç pretendon prokuroria, e as të lirohet nga akuzua, siç pretendon i akuzuari.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të lartësisë se dënimit ka pasur parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat kanë ndikuar në lartësinë e dënimit, ku rrethana lehtësuese për të akuzuarin ka marrë se është mbajtës i familjës, kurse si rrethana rënduese ka marrë parasysh, se vepra penale gjuajtjes me armë është kryer në oborrin e shtëpisë se të dëmtuarës, duke e rrezikuar të dëmtuarën dhe fëmijët, kurse veprën penale të kanosjes e ka kryer në sallën e gjykimit në prezencën e të gjitha palëve në procedurë, gjë që nuk është penduar as për veprat tjera penale, se më parë është gjykuar për vepra penale të ngjajshme dhe gjindet në vuajtjen e dënimit, sjelljet e të akuzuarit pas kryerjes se veprës penale, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale. Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e përmendura, si dhe mënyrën dhe rrethanat nën të cilat i ka kryer veprat penale, del se dënimin i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në

harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, se dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e në prani të këtyre rrethanave nuk ka vend që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i rëndë siç pretendon PTH apo më i butë siç pretendon i akuzuari, se dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij dhe të ndikojë edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënim ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401 të KPPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr. 579/2017 me 18.01.2018**

Procesmbajtësja,

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit,

Kimete Veseli

1. Have Haliti

Driton Muharremi

2. Mejreme Memaj